

Deri më tani 58 intelektualë dhe njerëz të njohur të skenës i janë bashkuar peticionit pro familjes dhe kundër homoseksualëve.

Në krye të listës është Adem Demaçi dhe më pas lista vazhdon me të tjerë intelektualë nga Shqipëria dhe Kosova.

Peticioni “Familje e shëndoshë- Atdhe i shëndoshë” vjen pas një parade të komunitetit LGBT në Tiranë.

“Jo shkatërrimit të familjes shqiptare!

Jo gjesteve që inkurajojnë cenimin e unitetit të familjes dhe shoqërisë!, raporton Tema.
Jo përkrahje publike modeleve që e shndërrojnë shoqërinë tonë në Sodomë dhe Gomorrë!

Sepse familja është embrioni i çdo shoqërie dhe i çdo qytetërimi. Familja është shoqëria në miniaturë. Familja fillon me fëmijët. Familja është mjedisi i parë, ku njeriu duhet të mësohet të krijojë mirësi. Paprekshmëria e familjes garanton sigurinë e shoqërisë së madhe njerëzore. Çdo doktrinë sociale, që përpiket të rrënojë familjen është e papranueshme dhe përveç kësaj, e pazbatueshme. Të rritesh në një familje vërtet të shëndetshme – ky është suksesi i sukseseve. Vartësia e jetës familjare e bën më të moralshëm njeriun. Një popull që nuk duron padrejtësitë në jetën familjare, nuk mund t'i kryejë ato në jetën shoqërore. Sepse familja është kristali i një shoqërie.

Populli shqiptar ka përjetuar mjaft mjerime, luftra, fatkeqësi e pushtime të huaja. Por të gjitha plagët ne i kemi shëruar dhe të gjitha fatkeqësitë i kemi kaluar, duke u mbështetur gjithnjë në moralin e lartë të një familje të bashkuar. Vlerat tona të familjes kanë qenë gjithnjë ato që na kanë mbajtur të qëndrojmë në këmbë me krenari e dinjitet. Ky ka qenë sekret i qëndresës sonë në përballimin e vështirësive që s'na i kurseu fati dhe kështu ka për të qenë në jetë të jetëve. Familja shqiptare është vlerë e shenjtë, e paprekshme!”, thuhet në peticion.

LISTA

1. Prof. Adem Demaçi Prishtinë
2. Prof. Milazim Krasniqi; Prishtinë
3. Kim Mehmeti; Shkup
4. Prof. Dr. Xhevat Lloshi
5. Prof. Dr. Muharrem Dezhgiu
6. Prof. Dr. Hasan Çipuri
7. Prof. dr. Murat Gecaj
8. Prof. dr. Pajtim Ribaj

9. Prof. dr. Aleksander Kocani
10. Prof. dr. Shyqyri Rreli
11. Prof. dr. Josif Papagjoni
12. Prof. dr. Stefan Çapaliku
13. Prof. dr. Ahmet Osja – Shkodër
14. Prof. Dr. Jashar Demiri- psikologji
15. Prof. Dr. Ejub Çota
16. Dr. Agron Tufa
17. Dr. Faruk Borova
18. Dr. Baki Dervishi
19. Dr. Agron Gjekmarkaj
20. Dr. Zef Gjeta
21. Dr. Angjelin Shtjefni
22. Dr. Fabian Zhilla
23. Dr. Arian Galdini
24. Dr. Agim Baçi
25. Dr. Çelo Hoxha
26. Alush Saraçi
27. Lefter Çipa
28. Sidrit Bejleri
29. Shpëtim Saraçi
30. Julian Deda
31. Albano Bogdo
32. Jonida Maliqi

33. Luljeta Lleshanaku
34. Vedat Ademi - këngëtar
35. Rexhep Çeliku
36. Armand Bora
37. Petrit Ruka
38. Frrok Çupi
39. Lazër Stani
40. Aleksandër Çipa
41. Agim Doçi
42. Ilir Kulla
43. Vladimir Beja
44. Salvador Kaçaj
45. Patrik Sadikaj
46. Roland Zili
47. Fitim Zekthi
48. Bardhyl Fico
49. Dr. Rezart Ajazi
50. Frano Kulli
51. Jozefina Traboini
52. Migena Barolli
53. Redi Shehu
54. Afrim Bilali
55. Bardhyl Selimi
56. Ramush Lekaj

57. Albano Bogdo

58. Ermal Mamaqi